

14 shtator 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 14.09.2026, Prishtinë

Shtyrja e ndeshjes së ProCredit Superkupës së Kosovës 2026


Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, dhe pas shqyrtimit të kërkesës zyrtare të Komunës së Rahovecit për shtyrjen e ndeshjes së ProCredit Superkupës së Kosovës 2026 ndërmjet KB Bashkimi dhe KB Trepça, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

1. Miratohet kërkesa e Komunës së Rahovecit për shtyrjen e ndeshjes së ProCredit Superkupës së Kosovës 2026 ndërmjet KB Bashkimi dhe KB Trepça, e planifikuar të zhvillohet më 15 shtator 2026, nga ora 19:00, në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec.
2. Ndeshja do të zhvillohet më 29 ose 30 shtator 2026, në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec.
3. Data dhe ora përfundimtare e zhvillimit të ndeshjes do të përcaktohen nga FBK-ja, në koordinim me Komunën e Rahovecit dhe KB Rahovecin 029, në cilësinë e klubit nikoqir, duke marrë parasysh të gjitha aspektet teknike dhe organizative të aktivitetit.
4. Autorizohet Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së që, pas përfundimit të koordinimit me palët përkatëse, të përcaktojë dhe t'ua komunikojë datën dhe orarin përfundimtar të zhvillimit të ndeshjes të gjitha palëve të përfshira.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

